



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

RELATI - RELATION

Nr./W 03-110-313/2

Data/Date 27-06-2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHMË
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: IPK/27062025/DI

Data: 27.06.2025

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektim në Policinë e Kosovës, Rregulloren (ZKM) Nr. 03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për Procedurën e Planifikimit, Inspektimit dhe Raportimit, Planin Zhvillimor Strategjik të IPK-së dhe Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (2025), Departamenti i Inspektimeve të IPK-së nxjerrë këtë:


RAPORT I INSPEKTIMIT

Titulli - objekti	- Reagimi në thirrjet e qytetarëve dhe raportimi i aktiviteteve policore
Referenca	- 03/2025
Data e inicimit	- 14.02.2025
Data e raportimit	- 27.06.2025
Arsyet e inicimit	- IPK ka mandat të kryejë inspektim në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështet Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plan Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit (2025) ka paraparë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit policor, duke përfshirë edhe atë të "reagimit policor në thirrjet e qytetarëve dhe raportimit të aktiviteteve policore". Inspektimi ka synuar të vlerësoj nëse stacionet janë në gjendje të përgjigjen në mënyrë efektive, të shpejtë në thirrjet e qytetarëve lidhur me shqetësimet e tyre. Po ashtu, IPK ka synuar që të vlerësoj nëse ka komunikim të duhur ndërmjet niveleve të organizimit sa i përket pranimit, shpërndarjes dhe kthimit të informatave. Inspektimi ka ofruar mundësi për të vlerësuar kapacitetet e stacioneve dhe gatishmërinë për reagim në ngritjen e sigurisë publike dhe krijimin e një mjedisi më të sigurt për qytetarët. IPK ka realizuar edhe më parë inspektim nga kjo fushë, por kësaj radhe është synuar që të vlerësohen arritjet dhe ngecjet.
Objektivat e inspektimit	- Matja dhe analizimi i kohës së reagimit policor në thirrjet e qytetarëve, - Vlerësimi i procesit të raportimit të aktiviteteve policore, dhe - Vlerësimi i dokumentimit të aktiviteteve policore sipas niveleve.
Metodologjia e inspektimit	- <u>Taking</u> : me shefat e operativës së dyzetë e një (41) stacioneve policore, si: Deçan, Dragash, Drenas, Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Gjakovë, Gjiilan, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Kllokot, Leposaviq, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovicë Jug, Mitrovicë Veri, Novo Bërdë, Obiliq, Partesh, Pejë, Podujevë, Prishtinë Jug, Prishtinë Qendër, Prishtinë Veri, Prizren, Prizren Veri, Rahovec, Ranillug, Skenderaj, Suharekë, Shtërpeç, Shtime, Viti, Vushtri, Zveçan dhe Zubin Potok; - <u>Kontrolle (këqyrje - verifikime)</u> të: pranimit/komunikimit dhe shpërndarjes së informatave mbi incidentet, reagimit policor në thirrjet e qytetarëve, dhe raportimit të aktiviteteve policore lidhur me ngjarjet (incidentet); - Marrja e dokumenteve fizike dhe elektronike, si: Logu ditor i ngjarjeve për Janar 2025 në 41 stacione, fletë patrullat/raportet e shpeja dhe raportet 24

	orë të situatës ditore (31 Janar 2025) në stacionet policore: Deçan, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë Veri, Rahovec, Suharekë, Viti dhe Vushtri.
Subjekti	- Stacionet policore në kundër të Drejtorive Rajonale Policore (41 sosh) Divizioni i Sigurisë Publike - Departamenti i Rendit Publik
Afatet e inspektimit	- Fillimi - 21.02.2025; - Përfundimi - 06.03.2025; - Periudha e mbulimit: Muaji Janar 2025 dhe gjendja aktuale.
Kriteri vlerësues (standardi)	- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - PSO - Koha e reagimit (07.09.2018), - PSO - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit (25.08.2020), - PSO - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës (28.10.2021), - PSO - Informimi nëpërmes raporteve të shpejta (23.08.2023), - PSO gjatë punës së përditshme - rutimore (27.08.2019).
Takimi përmbyllës (IPK-Policia e Kosovës)	- Më 25.06.2025 është realizuar takimi përmbyllës me strukturën policore të inspektuar, të përfaqësuar nga drejtues/bartës funksionesh nga Departamenti i Rendit Publik të Policisë së Kosovës.
Komentet policore lidhur me gjetjet dhe rekomandime	- Më 27.06.2025, struktura e inspektuar policore ka kthyer komentet lidhur me rekomandimet dhe Planin e veprimit të realizimit të tyre, të cilat janë bërë pjesë e këtij Raporti të inspektimit.
Ekipi realizues	- Fitore Gajraku, inspektor, - Mirsad Puqurica, inspektor, - Servet Tasholli, inspektor, - Shqiponjë Sopi, inspektor, - Taulant Nika, inspektor, - Teutë Ajeti - Rukolli, inspektor.
Mbikëqyrur nga	- Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	- Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Drejtuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Krveshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës.
Data	27.06.2025

Shkurtesat:

DRP	Drejtoria Rajonale Policore
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
QOKR	Qendra Operative Komunikuese Rajonale
QOKK	Qendra Operative Komunikuese Koordinuese
UA	Udhëzimi Administrativ



infosot.com

Faktet kyçe



Reagimi policor

Koha mesatare në nivel vendi

2022

2025

13.7 minuta

13.7 minuta

Reagimi më i shpejtë

DRP - Ferizaj

DRP - Ferizaj

9.12 minuta

10.4 minuta

Stacioni - Ferizaj

Stacioni - Kllëkot

8.49 minuta

7 minuta



Ecuria e reagimit (në minuta)

Kaktimi i detyrës (ndarja)

2022

2025

3.15

2.3

Arritja në vendngjarje

11.6

11.5



Reagimi sipas zonave (në minuta)

Zona urbane

2022

2025

11.6

12.4

Zona rurale

20.79

19.5



Reagimi në kohë

Reagimi brenda limiteve

2022

2025

80.05%

79.3%

Reagimet e shtyra

19.95%

20.7%



Reagimi sipas tipit të thirrjes

Aksident

2022

2025

11.42

12.6

Kommunikacion

13.28

13.8

Incident

13.95

14.7

Tjera

13.69

12.6

Vepër penale

17.04

16.2

Përmbledhje ekzekutive dhe rekomandimet

Inspektimi nxjerrë në pah se:

- ✚ Me gjithë përparimin e arritur në mbajtjen e evidencës së logut operacional, ende ka stacione që shënimet brenda tyre i kanë të mangëta (jo të plota) dhe metodologjia e futjes dhe pasqyrimit të informatave shpesh ato i bën të dallueshme. Kontrollët më të shpeshta menaxheriale dhe trajnimet konsiderohen instrumente që do të eliminonin dobësitë në mbajtjen e evidencave të logut.
- ✚ Treguesit statistikor mbi kohën e reagimit në pamje të përgjithshme nuk pasqyrojnë ndryshime krahasuar me matjet e para tre vitesh, me disa ndryshime individuale tek një numër stacionesh dhe drejtorish rajonale. Situata e ndjeshme e sigurisë në pjesën Veriore të vendit ka bërë që jale mobilizimit dhe përkushtimit të strukturës policore, të kemi një reagim më efektiv se më parë.
- ✚ Sa i përket qarkullimit të informatave dhe raportimit të aktiviteteve vërehet se ka një funksionim të duhur zinxhiror dhe se informatat brenda logut përpulhen me informatat e raportuara në fletë patrulla, raporte të shpejta dhe ato 24 orë të situatës ditore.
- ✚ Rekomandimet nga inspektimi i kaluar janë realizuar pjesërisht dhe deri ta monitorimit të reagimit përmes raporteve i është kështuar vëmendje nga strukturat e stacioneve, organizimi i trajnimeve lidhur me mbajtjen e logut dhe nxjerrja e një manuali mbi procedurën dhe veprimet e stacioneve në menaxhimin e informatave kanë ngecur.

Bazuar në gjetjet, përfundimet dhe nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve:

1. IPK i rekomandon komandantëve dhe shefave të operativës së stacioneve policore në Gjakovë, Janik, Lipjan, Malishevë, Novobërdë, Pejë, Prishtinë Jug, Prizren, Prizren Veri, Rahovec, Skenderaj, etj., që të shtojnë kontrollët në zyrat e radio komunikimit, në drejtim të përmirësimit të cilësisë së logut.
2. IPK i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Rendit Publik, që të sigurohet se organizimi i trajnimeve mbi mbajtjen e logut operacional dhe nxjerrja e një manuali operativ mbi procedurën dhe veprimet e stacioneve, janë instrumente që mund të rrisin cilësinë e punës në menaxhimin e informatave (thirrjeve).
3. IPK i rekomandon komandantëve dhe shefave të operativës së stacioneve policore në Lipjan, Rahovec, Pejë, Novobërdë, Prishtinë Jug, Prizren dhe Prishtinë Veri, që të analizojnë kohën e reagimit, për të identifikuar shkaktarët që ndikojnë në zgjatjen e saj.
4. IPK i rekomandon Komandantit dhe Shefit të Operativës së Stacionit Policor në Vushtri, që raportimet në fund të orarit përmes fletë patrullave të kryhen dhe të jenë të rregullta.

Gjetjet kryesore

1. Menaxhimi i thirrjeve dhe reagimi policor


1.1. IPK ka disa vite që trajton seriozisht thirrjet e qytetarëve për ndihmë dhe reagim. Në vitin 2022, IPK ka kryer një inspektim të zgjeruar, i cili është shtrirë në të gjitha stacionet policore të rendit publik. Gjatë inspektimit ishin evidentuar dobësi, vështirësi dhe sfida, andaj edhe janë dhënë një numër i rekomandimeve, përbushja e të cilave është në fokusin e këtij inspektimit të radhës. Është e njohur se Policia gjatë aktivitetit të saj policor mbledhë informata të ndryshme, në drejtim të parandalimit dhe hetimit të aktivitetit kriminal, dhe ngritjes së situatës së sigurisë në përgjithësi. Numër i madh i informatave janë thirrje të qytetarëve, institucioneve, që kërkojnë reagim, si përgjigje në ngjarjet që kanë ndodhur, apo pritet të ndodhin. Thirrjet kërkojnë trajtim dhe dhet ndjekur rrugën e duhur të qarkullimit të tyre, që të reagohet sa më shpejtë. DRP-të kanë rregulluar sistemin për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm, në formë të shkruar, verbale dhe elektronike. Në kuadër të drejtorive funksionojnë QOKR-të, si qendra të grumbullimit dhe shpërndarjes së informatave për gjithë incidentet që ndodhin brenda zonës së përgjegjësisë, të atyre që vijnë nga QOKK (DPPK) dhe qendrave - stacioneve të rajoneve tjera. Sa i përket koordinimit, QOKR-ja mbanë kontakte të vazhdueshme dhe koordinon punën me stacionet, njësitë në kuadër të DRP-së, shërbimet komunale dhe agjencitë tjera në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

1.2. QOKR administron informatat - thirrjet dhe lidhur me to mbanë evidenca përmes bazës së të dhënave. QOKR mban regjistrin e logut ditor të veprave penale, incidenteve dhe informatave tjera. Thirrjet në QOKR pranohen përmes numrit kujdestar 192, si dhe shërbimit emergjent në numrin kujdestar 112. Është hapur edhe aplikacioni on-line - Lajmëro Policinë, ku thirrjet e pranura në formë të shkruar, evidentohen në sistem. Sapo të pranohet informata nga dispeceri, automatikisht krijohet në sistem një dosje mbi ngjarjen, që gjeneron numrin identifikues si numër i thirrjes. Varsisht prej zonës ku ndodhë ngjarja, QOKR ia bartë thirrjen stacionit përkatës. Sistemi i komunikimit duke mbledhur informatat, kërkon një sërë të dhënash të nevojshme, që pasqyrohet si Log i ngjarjeve ditore. Logu është një pasqyrë e krijuar elektronike, apo me shkrim, ku evidentohen informimet telefonike, të pranura nga cilido informues i mundshëm, për një rast, apo ngjarje të caktuar, të ndodhur më parë, apo që është në zhvillim e sipër. PSO - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës qartëson se "të gjitha qendrat e komunikimit në nivel qendror dhe lokal duhet të përdorin sistemin e SIPK-O (Logu e operacioneve), për t'i evidentuar thirrjet dhe raportimet, të cilat raportohen në Policinë e Kosovës nga ana e qytetarëve". Stacionet policore janë lidhur on-line në sistemin e komunikimit, i cili e mbanë Logun. Në stacione funksionojnë bazat e komunikimit, ku zyrtarët e tyre punojnë në tre (3) ndërrime. Qasja në këtë sistem sigurohet përmes lejeve kalimtare dhe zyrtarët e caktuar mund të fusin të dhëna mbi reagimin. Mbikëqyrësit e ndërrimeve prioritetizojnë thirrjet dhe ndajnë detyrat tek njësitë policore për reagim.

1.3. IPK edhe këtë herë ka shtrirë inspektimin në të gjitha stacionet policore të rendit, nga logjet operationale të të cilave janë nxjerrë 5.214 mostra për muajin Janar të këtij viti. Numri i ngjarjeve (thirrjeve) është më i madh për dallim nga mostra e përzgjedhur, por që për shkak objektivë e subjektivë, ka qenë e pamundur të sigurohet mostër më e gjerë, si rezultat i mungesës së të dhënave të nevojshme. Koha e reagimit llogaritet nga pranimi i informatës nga QOKR, mbikëqyrësi, apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës tek patrulla/njësi që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës dhe arritja në vendin e ngjarjes. Matjet e vitit 2022 patën pasqyruar se koha e përgjithshme mesatare e reagimit nga njësitë policore të stacioneve ka qenë 13.76 minuta. Matjet e fundit pasqyrojnë se kjo kohë nuk ka ndryshuar dhe ka mbetur e njëjtë - 13.7 minuta. Nëse reagimin e trajtojmë nga këndvështrimi rajonal, Ferizaj, Mitrovicë Veri dhe Mitrovicë Jug kanë reagimin më të shpejtë krahasuar me drejtoritë tjera. Kohën e reagimit më së shumti e ka përmirësuar DRP-Mitrovicë Veriu, si rezultat i mobilizimit për shkak të situatës së sigurisë në zonën e saj të përgjegjësisë. Gjakova,

Gjilani, Prishtina kanë performuar në nivel të mesatares, derisa Prizreni dhe Peja kanë pasur reagim më të shtyrë. Shtatë stacione (Klllokot, Han i Elezit, Gjakovë, Kamenicë, Shtime, Ferizaj dhe Leposaviq) kanë pasur reagim mesatar nën 10 minuta, si më të shpejtat krahasuar me stacionet tjera.

Diag. 1 – Krahasimi i kohës së reagimit sipas DRP-ve (2022 dhe 2025)



1.4. Nga momenti i pranimit të thirrjes krijohet një vonesë deri në caktimin (ndarjen) e detyrës për njësinë reaguese, që ndikon edhe në zgjatjen e periudhës për dalje në vend ngjarje. Pas pranimit të thirrjes, drejtoria rajonale bartë thirrjen në stacionin, në zonën e të cilit ndodhë ngjarja. Ndarja e detyrës dallohet nga njëri stacion në tjetrin dhe shpesh mund të zgjatet për shkak të mungesës së personelit të lirë edhe të automjeteve. Nga mostrat e muajit Janar, koha e përgjithshme mesatare e ndarjes së detyrës (caktimit) është 2.2 minuta, kohë kjo afërsisht e njëjtë me atë të vitit 2022 (2.15 minuta). DRP-të në Ferizaj dhe Mitrovicë Jug kanë kohën më të shkurtër të ndarjes së detyrave me 0.5, përkatësisht 1.1 minuta, derisa kohën më të gjatë e ka regjistruar DRP - Pejë me 3.3 minuta edhe pse është kohë më e shkurtër se ajo e inspektimit të kaluar. Sa i përket matjeve në nivel stacionesh, Gjakova, Juniku dhe Klllokoti kanë kohën më të shpejtë të caktimit të detyrës. Në anën tjetër, stacionet policore në Prishtinë Veri, Istog, Prishtinë Jug, Novo Bërdë dhe Skënderaj kanë regjistruar kohën më të gjatë të ndarjes së detyrës (7.6, 7, 6.4, 5.7 dhe 5 minuta). Siç shihet edhe në diagram, nëse zbritet koha e humbur për caktimin e detyrës, del se mesatarja e përgjithshme e reagimit policor në nivel të të gjitha drejtorive/stacioneve është 11.5 minuta ($13.7 - 2.2 = 11.5$ minuta).

Diagrami 2 - Periudha e reagimit deri në vendin e ngjarjes (Janar 2024)



1.5. Sipas PSO, koha e reagimit për zona urbane parashihet të jetë maksimum 15 minuta dhe për zonën rurale, maksimum 30 minuta, varësisht nga lokacioni ku ndodhë rasti (me përjashtime eventuale në zona të thella malore dhe me kushte të papërshtatshme atmosferike). Sipas PSO-së, njësi patrullues për t'u përgjigjur rastit në fjalë, duhet të përpiqet maksimalisht që në afat sa më optimal t'i përgjigjet kërkesës së qytetarit, apo nevojës për reagim. Nga 4,298 mostra të reagimit në zona urbane rezulton një mesatare e përgjithshme prej 12.4 minuta. Nga 916 mostra të reagimit në zona rurale rezulton një mesatare prej 19.5 minuta. Kur shohim performancën në nivel të përgjithshëm, duket se këto dy kohë janë brenda limiteve prej 15 dhe 30 minutave, varësisht prej


zonës. Reagimin më të shpejtë në zonë urbane e kanë DRP-të në Ferizaj dhe Gjakovë, me kohë mesatare prej 9.3, respektivisht 10.2 minuta, derisa më të shtyrë e ka DRP në Prizren me 14.8 minuta. Sa i përket reagimit në zona rurale, reagimin më të shpejtë e kanë DRP-të në Mitrovicë Veri dhe Ferizaj me 14.2, respektivisht 16.3 minuta, derisa reagimin më të shtyrë e ka DRP - Gjakovë me 21.9 minuta. Sa i përket performancës së stacioneve, tre (3) prej 39 sish kanë regjistruar kohë mesatare të reagimit në zonë urbane mbi limitin prej 15 minuta, kurse një (1) nga 37 stacione policore ka regjistruar kohë mesatare të reagimit në zonë rurale mbi limitin prej 30 minutave. Stacionet me reagimin më të shpejtë në zonë urbane janë Hani i Elezit me 4.5 minuta dhe Dragash me 6 minuta. Kurse, reagimin më të shtyrë e kanë Prishtinë Veri me 20.4 dhe Prizreni me 19.4 minuta (referoju shtojcës).

Diagrami 3 - Reagimi sipas zonave urbane - rurale (Janar 2025)



1.6. IPK ka analizuar vonesat e shkaktuar mbi limitet e përcaktuar me PSO (maksimum 15 minuta në zonë urbane dhe 30 minuta për atë rurale). Në 1,079 nga 5,214 mostra të analizuar, reagimet kanë qenë përtej limiteve të përcaktuara me PSO (20.7%). Sipas matjeve për reagimin në zona urbane dhe rurale, del se afërsisht në çdo të pestën thirrje reagohet me vonesë, apo thënë më ndryshe, në 2 nga 10 thirrje të qytetarëve reagohet me vonesë. Siç shihet edhe nga diagrami, DRP në Ferizaj është regjioni ku në zonën e përgjegjësisë së saj është regjistruar mesatarja më e ulët e vonesave në lartësi prej 9.9% (10% për reagimet në zona urbane dhe 9.8% për zonat rurale). DRP - Prishtinë është regjioni ku në zonën e përgjegjësisë së saj është regjistruar mesatarja më e lartë e vonesave në lartësi prej 25.3% (26.3% për reagimet në zona urbane dhe 18.6% për zonat rurale). Sipas matjeve, 13 stacione policore kanë regjistruar vonesë në reagim mbi mesataren e përgjithshme, pa marrë parasysh zonën (më tepër se 2 vonesa në çdo 10 thirrje). Prishtinë Veri, Prizreni dhe Prishtinë Jugu janë tre (3) stacione, që kanë regjistruar mesataren më të lartë të numrit të vonesave.

Diagrami 4 - Përqindja mesatare e numrit të rasteve ku është reaguar me vonesë (sipas DRP-ve)



1.7. Sistemi i menaxhimit të informatave dhe komunikimit përmes Logut mundëson evidentimin e thirrjeve edhe sipas tipit. IPK është interesuar të njihet me reagimin sipas këtyre tipave veç e veç. Sipas matjeve të përgjithshme, të bëra nga 5,214 mostra, reagimet më të shpejta bëhen për "aksidentet" me një mesatare të përgjithshme prej 12.6 minuta, kurse më të shtyra bëhen për thirrjet që lidhen me "vepra penale" (16.2 minuta). Nëse reagimet policore për këto dy tipe thirrjesh i krahasojmë me rezultatet e

përgjithshme të matjeve të vitit 2022, shohim se për thirrjet e tipit "aksident" ka një zgjatje të kohës së reagimit afërsisht mbi 1 minutë (nga 11.4 në 12.6 min), kurse për thirrjet e tipit "vepër penale" ka një kohë reagimi më të shkurtër afërsisht për 1 minutë (nga 17.04 në 16.2 min). Sa i përket performancës në nivel të drejtorive rajonale, pesë (5) nga tetë (8) prej tyre reagojnë më shpejtë në rastet "aksidente", krahasuar me tipat tjerë, në dy (2) nga drejtoritë rajonale, reagimet më të shpejta ndodhin për thirrjet që lidhen me "tjera", kurse në një (1) drejtori tjetër, reagimet më të shpejta ndodhin për thirrjet e tipit "vepër penale". Sa i përket performancës në nivel stacionesh lidhur me reagimet sipas tipit të thirrjeve, rezultojnë se 9 nga 41 prej tyre kanë reaguar më shpejtë në thirrjet e tipit "aksident", 10 në thirrjet e tipit "komunikacion", 11 në "incidente", 6 në "tjera" dhe 3 në "vepra penale".

Diagrami 5 - Mesatarja e përgjithshme e reagimit sipas tipit të thirrjes (ilogaritur në minuta)



1.8. IPK në Raportin e inspektimit Nr. 07/2022 ka dhënë një numër rekomandimesh, përfshirë dhe ato që lidhen me cilësinë e mbajtjes së logut operacional. Ky inspektim vë në pah se të gjitha stacionet mbajnë logun standard të ngjarjeve, por që metodologjia e pasqyrimit të informatave brenda tij vazhdon të jetë e ndryshme. Logjet në disa stacione policore vazhdojnë të kenë mungesë të informatave mbi kohën e arritjes së njësive policore në vend ngjarje dhe ndarjen e detyrës për ekipet reaguese. Në disa logje ka hapje të numrave të dosjeve për shumicën e thirrjeve, derisa ka stacione që hapin numra vetëm për thirrjet që dyshohet se lidhen me raste. Mungesa e informatave në logje ka ndikuar edhe në sigurimin e një mostre thirrjesh më të kufizuar për analizë. Me gjithë faktin se tek një numër stacionesh ka lëvizje pozitive sa i përket mirë administrimit të informatave brenda logjeve operationale, ka ende gjëra që duhet përmirësuar: zhvilluar të disa stacione. Me gjithë faktin që qendrat komunikuese mund të jenë të ngarkuara me administrimin e informatave mbi thirrjet dhe reagimin, nevojitet që një numër stacionesh policore (Gjakovë, Junik, Lipjan, Malishevë, Novobërdë, Pejë, Prishtinë Jug, Prizren, Prizren Veri, Rahovec, Skenderaj, etj.) të angazhohen në ngritjen e cilësisë së logut, meqë ato duhet të jenë me informata më të plota dhe më të garta.

1.9. IPK është njohur edhe me vështirësitë dhe sfidat, me të cilat ballafaqohen stacionet, që mund të ndikojnë në arritjen e kohës më efektive të reagimit. IPK ka identifikuar se angazhimet e stacioneve në ofrimin e kapaciteteve të nevojshme të burimeve njerëzore për shkak të situatës së sigurisë në pjesën veriore të vendit, mungesa e automjeteve, konfiguracioni gjeografik, janë disa prej faktorëve që kanë sfiduar performancën e duhur të stacioneve në përgjigje të thirrjeve të qytetarëve.

2. Komunikimi i informatave dhe raportimi

2.1. Siç u cekë në pjesën e epërme të këtij Raporti, ka raste kur informatat rrjedhin/vijnë nga niveli qendror, rajonal dhe ai lokal, varësisht ku adresohet thirrja. Nuk është vërejtur ndonjë situatë që të ketë ngecur komunikimi ndërmjet niveleve, si dhe shpërndarja e informatave. Janë evidentuar situata kur reagimi nuk ka mundur të jetë i menjëhershëm, si rezultat i mungesës së ekipeve të lira, por dhe mungesës së automjeteve. Edhe kësaj radhe bie në sy modeli i organizimit të QORK - Ferizaj, që ka rezultuar me reagim më efektiv dhe më të shpejtë në thirrjet e qytetarëve. Edhe në kuadër të DRP-Mitrovicë Veri

ka pasur një rezultat të dukshëm pozitiv, qoftë në komunikimin efektiv, shpërndarjen e informatave, por edhe reagimin më të shpejtë policor, gjë që e dëshmon edhe të dhënat statistikore mbi reagimin policor.

2.2. Sa i përket ofrimit të informatave kthyesë mbi reagimin, IPK ka pasur fokusin edhe në raportimin e aktiviteteve policore nga stacionet policore, në ngjarjet që kanë mundur të rrydhen nga thirrjet e qytetarëve. Neni 24 i UA Nr. 01/2012 për Mënyrën e Kryerjes së Detyrave dhe Autorizimeve Policore përcakton se "për ushtrimin e autorizimeve policore, zyrtari policor duhet t'i shënojë ato në raport, t'i dorëzojë të mbikëqyrësi i parë në strukturën komanduese të Policisë, në formularin përkatës për këtë, që do të shërbejë si dokumentim i veprimit të marrë". Edhe PSO - Sistemet Informative të Policisë së Kosovës në kapitullin b (Funksionet), pika 5 (Raportet e patrullave) përcakton që "të gjithë zyrtarët policor - patrullues, të cilët punojnë në drejtori rajonale policore, stacione policore dhe njësi tjera policore duhet të përdorin SIPK-O për t'i evidentuar raportet për aktivitete gjatë punës në patrullë, ku në kuadër të këtyre raporteve përfshihen aktivitetet, të cilat parashihen të realizohen gjatë kohës së patrullimit në terren". Sipas kësaj PSO, forma e raportit të patrullave do të jetë e vetmja formë që do të shfrytëzohet nga personeli i Policisë, për raportim nga patrullat dhe mbledhjen e të dhënave në bazë të ligjit në fuqi në Republikën e Kosovës. IPK ka verifikuar në tetë (8) stacione nëse ato në një datë të caktuar kanë raportuar në mënyrën e përcaktuar¹. Inspektimi i këtyre stacioneve ka vënë në pah se vetëm Vushtrri nuk ka prezantuar që njësitë policore në fund të ndërrimeve plotësojnë fletë patrullat. Stacionet policore në Deçan, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë Veri, Rahovec, Suharekë, Viti raportojnë rregullisht përmes fletë patrullave. IPK ka krahasuar të dhënat në fletë patrulla, me logun operacional dhe verifikimi i kryer dëshmon se për thirrjet e pranura në datën e caktuar, ka pasur reagim dhe lidhur me aktivitetin e zhvilluar ka informacion brenda formularit. Informatat përmblendhëse nga këta formularë janë pjesë e raporteve 24 orë të situatës ditore, raporte këto që janë prezantuar nga të gjitha stacionet. Siç parashihet edhe me procedura operative, QOKK përgatitë Raportin e Situatës Ditore, ku përfshihen rastet mëdha që raportohen brenda territorit të Republikës së Kosovës.

2.3. Sa i përket raportimit të ngjarjeve, IPK ka analizuar edhe PSO-Informimi nëpërmes raporteve të shpejta². Dokument ky që obligon strukturat policore që trajtojnë/reagojnë në incidente mëdha, të raportojnë përmes raporteve të shpejta. Sipas kësaj, "raporti i shpejtë duhet përpiluar dhe dërguar brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme, dhe në secilin rast jo më vonë se dy (2) orë nga informimi për incident/rast me aq të dhëna sa janë sigurtar". Inspektorët kanë verifikuar nëse në datë të caktuar (31 Janar 2025) janë raportuar incidente mëdha dhe nëse lidhur me to ka pasur raportime përmes raporteve të shpejta. Numri i raporteve të shpejta të përpiluara nga stacionet ka qenë i vogël, sepse në datën e caktuar ka qenë i vogël edhe numri i incidenteve mëdha, siç i precizon edhe PSO. Duhet potencuar se në rastet kur ka pasur incidente mëdha, lidhur me to janë hartuar raporte të shpejta, të cilat janë pasqyruar edhe në fletë patrulla të njësave përkatëse dhe raporte 24 orë.

¹ Sipas Programit të punës inspektuese, IPK ka përzgjedhur datën 31 Janar 2025, për të verifikuar thirrjet, reagimet policore të tetë (8) stacioneve, si dhe raportimin e tyre përmes fletë patrullave, raporteve të shpejta dhe atyre 24 orë. Në fokusin e inspektimit ka qenë pranimi i thirrjeve, ndarja e detyrës (shpërndarja), reagimi dhe raportimi.

Përfundim	Bazuar në gjetjet e inspektimit, IPK vlerëson se: 1. Stacionet policore mbajnë logun operacional të ngjarjeve, vetëm se metodologjia se si futen dhe pasqyrohen të dhënat nuk është uniforme (organizimi i trajnimeve dhe kontroleve nga mbikëqyrësit do të mund të rrisë cilësinë e logut). 2. Nuk është hasur të jetë hartuar një udhëzues operativ mbi procedurën dhe veprimet e stacioneve në menaxhimin e informatave, siç është rekomanduar më parë, njëjtë sikurse nuk ka informacion nëse është organizuar trajnim mbi administrimin e logut. 3. Me gjithë faktin se ka përpunim në mbajtjen e evidencave të logut operacional, ende në një numër të logjeve mungojnë të dhënat mbi kohën e arritjes së njësitve policore në vendngjarje, ndarjen e detyrave, etj. 4. Koha e reagimit në vendngjarje dallohet nga stacioni në stacion dhe vazhdojnë të kenë ndikim faktorët, si: shtrirja gjeografike, zona e përgjegjësisë, burimet njerëzore, logjistika, etj. Periudha e ndarjes së detyrës dhe më pas ajo e reagimit nga patrullat policore, vazhdojnë të mbesin në shifra të pandryshuara si para tre (3) viteve. 5. Koha e përgjithshme e reagimit nuk ka lëvizur nga ajo e matur para tre (3) viteve, vetëm se ka ndryshime në disa drejtori e stacione. DRP- Ferizaj vazhdon të jetë lider në arritjen e një kohe më efektive, por se ka lëvizje edhe sa i përket DRP - Mitrovicë Veriu, si rezultat i mobilizimit për shkak të situatës së ndjeshme të sigurisë. 6. Krahasuar me matjet e vitit 2022, pasqyrohet një zgjatje e kohës së reagimit në zonat urbane, derisa paraqitet një shkurtime i kohës së reagimit në zonat rurale. Reagimi në tre tipe thirrjesh ka shënuar një zgjatje në kohë (për 0.5 - 1 minutë), derisa tek dy tipe tjera ka shënuar shkurtime (për rreth 1 minutë). 7. Stacionet kanë filluar të monitorojnë kohën e reagimit në thirrjet e qytetarëve, ashtu siç është rekomanduar nga IPK dhe kjo pasqyrohet përmes raporteve të matjeve në vazhdimësi. 8. Inspektimi pasqyron se raportimi i aktivitetëve në fund të orarit ditor përmes fletë patrullave nga njësitë policore, është duke funksionuar dhe është hasur se ka një lidhshmëri ndërmjet ngjarjeve në logje dhe atyre të prezantuara në fletë patrulla¹. 9. Konform obligimeve që parashihen me procedura operative, raportimi i incidenteve mëdhorë përmes raporteve të shpejta, si dhe përcjellja e raporteve 24 orë të situatës ditore është duke ndodhur nga ana e stacioneve policore si procedurë e rregullt.
------------------	--

¹ Stacioni Policor në Vushtri nuk ka prezantuar fletë patrulla, raportime këto të rregullta që i praktikojnë të gjitha stacionet tjera të inspektuara.

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1	IPK iu rekomandon komandantëve dhe shefave të operativës së stacioneve policore në Gjakovë, Junik, Lipjan, Malishevë, Novobërdë, Pejë, Prishtinë Jug, Prizren, Prizren Veri, Rahovec, Skenderaj, etj., që të shtojnë kontrollin në zyrat e radës komunikimit, në drejtim të përmirësimit të cilësisë së logut.	-I-	Drejtori Rajonal të DRP-përkatese caktojnë Shefat e Operativës Rajonale të cilët do të mbikëqyrin angazhimin e Komandantëve të Stacioneve Policore, të cilët janë të përfshirë në këtë rekomandim, ku të njëjtit do të mbikëqyrin dhe do të shtojnë kontrollin në Qendrat e Komunikimit si dhe kryejnë inspektimin të vazhdueshme për përmirësimin e logut operativ.	Mbikëqyrje dhe kontroll në vazhdimësi
2	IPK i rekomandon Drejtorin të Departamentit të Rendit Publik, që të sigurohet se organizimi i trajnimeve mbi mbajtjen e logut operacional dhe nxjerrja e një manuali operativ mbi procedurën dhe veprimet e stacioneve, janë instrumente që mund të rrisin cilësinë e punës në menaxhimin e informaturave (thirrjeve).	-I-	Drejtori i Departamentit të Rendit Publik me një shkresë të veçantë do të ua sqarojë Drejtorisë Rajonale pikat e kërkuara në këtë Rekomandim edhe pse të njëjtat janë të sqaruara përmes manualit të veçantë për çështje të tilla. Gjithashtu do të kërkojë nga Drejtoret Rajonal që të mbikëqyrin me kujdes plotësimin e këtij rekomandimi.	Mbikëqyrje dhe kontroll në vazhdimësi
3	IPK iu rekomandon komandantëve dhe shefave të operativës së stacioneve policore në Lipjan, Rahovec, Pejë, Novobërdë, Prishtinë Jug, Prizren dhe Prishtinë Veri, që të analizojnë kohën e reagimit, për të identifikuar shkaktarët që ndikojnë në zgjatjen e saj.	-I-	Drejtoret Rajonal të DRP-përkatese caktojnë Shefat e Operativës Rajonale të cilët do të mbikëqyrin angazhimin e Komandantëve të Stacioneve Policore, të cilët janë të përfshirë në këtë rekomandim, ku të njëjtit do të bëjnë analizë të ndryshme lidhur me kohën e reagimit dhe do të angazhohen në përmirësimin e kohës së reagimit.	Mbikëqyrje dhe kontroll në vazhdimësi
4	IPK i rekomandon Komandantit dhe Shefit të Operativës së Stacionit Policor në Vushitri, që raportimet në fund të orarit përmbledhje përditshme të kryhen dhe të jenë të rregullta.	-I-	Drejtori Rajonal i DRP-Mitrovicë Jugë cakton Shefin e Operativës Rajonale, i cili do të mbikëqyrë angazhimin e Komandantit dhe Shefit të Operativës së Stacionit Policor përkates, të cilët do të jenë të angazhuar në mbikëqyrjen dhe kontrollin e vartësve të tyre që ky rekomandim të jetë i plotësuar.	Mbikëqyrje dhe kontroll në vazhdimësi

Shtojca 1 - Përmbledhje analitike e kohës së reagimit në thirrjet e qytetarëve (Janar 2025)				
Stacionet sipas rezultatit	Numri i mostrave	Periudha e ndarjes së detyrës	Periudha e daljes në vend ngjarje	Koha e reagimit (min)
Kllokot	4	0	7	7
Hani i Elezit	15	0.3	7	7.3
Gjakovë	106	0	9	9
Kamenicë	31	0.4	8.7	9.1
Shtime	90	0.4	8.9	9.3
Ferizaj	708	0.1	9.5	9.6
Leposaviq	10	0.7	9.3	10
Vushtri	170	1.6	9	10.6
Mitrovice Veriu	60	2.2	8.5	10.7
Prishtinë Qendër	968	2.2	9.9	12.1
Junik	5	0	12.1	12.4
Suharekë	133	1.3	11.1	12.4
Mitrovicë Jugu	414	0.4	12.3	12.7
Obiliq	107	1.4	11.3	12.7
Viti	41	0.1	12.6	12.7
Zubin Potok	3	1.3	11.4	12.7
Deçan	31	2.6	10.2	12.8
Skenderaj	44	5	8.5	13.5
Podujeve	148	0.4	12.8	13.6
Gjilan	368	2.7	11.6	14.3
Klinë	74	1.6	13.3	14.9
Fushë Kosovë	394	3	12.2	15.2
Kaçanik	53	2.8	13.1	15.9
Malishevë	24	0.6	15.4	16
Ranillug	8	2.8	13.2	16
Drenas	99	3.6	13	16.6
Zveqan	16	3.6	13	16.6
Istog	112	7	9.7	16.7
Prizren Veriu	18	0.5	16.5	17
Prishtinë Jugu	241	6.4	10.9	17.3
Dragash	14	3	14.4	17.4
Pejë	117	1.2	16.4	17.6
Shtërpoc	49	4.6	13.5	18.1
Graçanicë	117	2	16.4	18.4
Rahovec	77	3.1	15.7	18.8
Prizren	96	2.5	17.7	20.2
Prishtinë Veriu	173	7.6	13.2	20.8
Lipjan	59	2.1	19.3	21.4
Novobërdë	17	5.7	23.6	29.3
Gjithsej⁴	5.214	2.2	11.5	13.7

⁴ Në këto matje nuk janë përfshirë stacionet policore në Partesh dhe Mamushë, meqë nga logjet operationale nuk është mundur të sigurohen mostra.

Shtojca 2 - Përmbledhje analitike e kohës së reagimit sipas zonave që mbulojnë stacionet						
Stacionet sipas rezulttit	Numri i mostrave			Koha e reagimit (minuta)		
	Gjithsej	Urbane	Rurale	Urban	Rural	Përgjithshme
Klllokot	4	3	1	7.7	5	7
Hani i Elezit	15	11	4	4.5	15.3	7.3
Gjakovë	106	83	23	7.1	15.7	9
Kamenicë	31	18	13	10.3	7.4	9.1
Shtime	90	52	38	6.9	12.4	9.3
Ferizaj	708	662	46	9.4	12.9	9.6
Leposaviq	10	1	9	10	10	10
Vushtrri	170	147	23	9.4	18.7	10.6
Mitrovica Veriu	60	58	2	10.6	14.5	10.7
Prishtinë Qendër	968	967	1	12.1	6	12.1
Junik	5	5	0	12.4	0	12.4
Suharekë	133	67	66	9.5	15.3	12.4
Mitrovicë Jugu	414	366	48	12	18.2	12.7
Obiliq	107	46	61	10.2	14.6	12.7
Viti	41	18	23	8.7	15.8	12.7
Zubin Potok	3	1	2	11	13.5	12.7
Deçan	31	23	8	11.3	17.1	12.8
Skenderaj	44	29	15	8.2	23.8	13.5
Podujevë	148	105	43	10.4	21.5	13.6
Gjilan	368	349	19	13.6	26.4	14.3
Klinë	74	33	41	8.5	20	14.9
Fushë Kosovë	394	378	16	14.4	34.3	15.2
Kaçanik	53	30	23	11.4	21.8	15.9
Malishevë	24	12	12	11.1	21	16
Ranillug	8	4	4	9.5	22.5	16
Drenas	99	40	59	12.7	19.4	16.6
Zveçan	16	3	13	14	17.2	16.6
Istog	112	55	57	12.9	20.3	16.7
Prizren Veriu	18	8	10	14.5	19	17
Prishtinë Jugu	241	241	0	17.3	0	17.3
Dragash	14	3	11	6	20.5	17.4
Pejë	117	92	25	16	23.5	17.6
Shtërpce	49	17	32	10.4	22.1	18.1
Graçanicë	117	63	54	14.7	21.5	18.4
Rahovec	77	54	23	14.7	28.6	18.8
Prizren	96	86	10	19.4	27.6	20.2
Prishtinë Veriu	173	140	33	20.4	22.6	20.8
Lipjan	59	25	34	13.5	27.3	21.4
Novobërdë	17	3	14	28	29.6	29.3
Gjithsej	5,214	4,298	916	12.4	19.5	13.7

Shtojca 3 - Përmbledhje analitike e rasteve kur ka pasur reagim të shtyrë (të ngathtë)									
Stacionet	Reagimet e shtyra (me vonesë)								
	Mostra gjithsej	Reagim i ngathtë	%	Mostra urbane	Reagim i ngathtë	%	Mostra rurale	Reagim i ngathtë	%
Klllokot	4	0	0	3	0	0	1	0	0
Leposaviq	10	0	0	1	0	0	9	0	0
Zubin Potok	3	0	0	1	0	0	2	0	0
Shtime	90	4	4.4	52	3	5.8	38	1	2.6
Prizren V	18	1	5.6	8	1	12.5	10	0	0
Hani i Elezit	15	1	6.7	11	0	0	4	1	25
Viti	41	3	7.3	18	1	5.6	23	2	8.7
Gjakovë	106	8	7.5	83	6	7.2	23	2	8.7
Suharekë	133	11	8.3	67	6	9	66	5	7.6
Ferizaj	708	66	9.3	662	64	9.7	46	2	4.3
Kamenicë	31	3	9.7	18	3	16.7	13	0	0
Obiliq	107	12	11.2	46	3	17.4	61	4	6.6
Klinë	74	9	12.2	33	4	12.1	41	5	12.2
Ranillug	8	1	12.5	4	0	0	4	1	25
Zveqan	16	2	12.5	3	1	33.3	13	1	7.7
Vushtrri	170	22	12.9	147	17	11.6	23	5	21.7
Shtërpeç	49	7	14.3	17	2	11.8	32	5	15.6
Deçan	31	5	16.1	23	5	21.7	8	0	0
Malishevë	24	4	16.7	12	1	8.3	12	3	25
Prishtinë Q	968	169	17.5	967	169	17.5	1	0	0
Mitrovicë V	60	11	18.3	58	11	19	2	0	0
Istog	112	22	19.6	55	14	25.5	57	8	14
Junik	5	1	20	5	1	20	0	0	0
Mitrovicë J	414	83	20	366	78	21.3	48	5	10.4
Drenas	99	20	20.2	40	13	32.5	59	7	11.9
Skenderaj	44	9	20.5	29	3	10.3	15	6	40
Dragesh	14	3	21.4	3	0	0	11	3	27.3
Podujevë	148	32	21.6	105	22	21	43	10	23.3
Kaçanik	53	13	24.5	30	8	26.7	23	5	21.7
Gjilan	368	91	24.7	349	86	24.6	19	5	26.3
Fushë Kosovë	394	108	27.4	378	101	26.7	16	7	43.8
Graçanicë	117	35	29.9	63	24	38.1	54	11	20.4
Lipjan	59	19	32.2	25	9	36	34	10	29.4
Rahovec	77	25	32.5	54	21	38.9	23	4	17.4
Pejë	117	40	34.2	92	35	38	25	5	20
Novobërdë	17	7	41.2	3	2	66.7	14	5	35.7
Prishtinë J	241	104	43.2	241	104	43.2	0	0	0
Prizren	96	43	44.8	86	39	45.3	10	4	40
Prishtinë V	173	85	49.1	140	78	55.7	33	7	21.2
Gjithsej	5.214	1.079	20.7	4.298	940	21.9	916	139	15.2

Shtojca 4 - Përmbledhje analitike e kohës së reagimit sipas tipit të thirrjeve										
Stacioni	Aksidente		Komunikacion		Incidente		Tjera		Vepër penale	
	Mostra	Koha	Mostra	Koha	Mostra	Koha	Mostra	Koha	Mostra	Koha
Klllokot	1	10	0	0	2	6.5	1	5	0	0
Hani i Elezit	8	4.1	0	0	0	0	5	5.4	2	25
Gjakovë	36	9.8	13	8.5	4	7	24	10.1	29	7.4
Kamenicë	7	7	0	0	16	7.6	3	21.7	5	9.2
Shtime	35	6.8	11	9.6	23	12.9	12	6.6	9	12.7
Ferizaj	146	9.5	255	10.1	59	8.8	159	8.8	89	10.4
Leposaviq	1	8	1	3	5	12.2	3	9.3	0	0
Vushteri	39	11.2	25	10.2	6	5.8	84	9.6	16	17.3
Mitrovicë V	7	14.4	7	14.4	15	8.9	28	9.3	3	15
Prishtinë Q	213	13	331	13.6	113	12.2	240	9.8	71	10.4
Junik	0	0	0	0	0	0	5	12.4	0	0
Suharekë	59	12.7	9	8.3	15	7.9	29	15.6	21	12.1
Mitrovicë J	70	10.1	127	12.9	85	12.8	101	14.3	31	13
Obiliq	20	12.1	17	10.6	10	10.2	41	11.5	16	20.7
Viti	17	10.6	2	3.5	13	16.4	3	11	6	14.3
Zubin Potok	0	0	0	0	3	12.7	0	0	0	0
Deçan	13	8.8	1	13	8	19.5	4	6.3	5	18
Skenderaj	11	12.6	7	6.9	8	12.5	11	16.5	7	18.1
Podujevë	45	12.4	27	11.6	28	12.6	29	13.1	19	21.9
Gjilan	67	10.9	137	15.9	41	16.9	82	11.4	41	17.4
Klinë	29	10.6	9	16.1	7	19.7	20	17.2	9	18.8
Fushë K	78	14.3	114	20.2	57	10.1	119	12	26	22.5
Kaçanik	15	14.5	11	18.2	0	0	16	15.3	11	16.4
Malishevë	8	14.6	1	12	7	17.1	3	21.3	5	14.4
Ranillug	1	27	0	0	3	9.3	3	21	1	10
Drenas	37	17.7	6	10.3	2	27.5	35	17.5	19	13.9
Zveqan	1	34	0	0	4	17	7	12.4	4	19.5
Istog	34	11.1	2	6.5	18	18.5	37	16.2	21	26
Prizren V	3	16.3	0	0	7	16	3	16	5	19.4
Prishtinë J	71	17.3	19	19.2	54	17.2	44	17.1	53	16.9
Dragash	5	13.8	2	9	2	9.5	2	19.5	3	33
Pejë	20	13.8	10	19.2	40	16.4	30	20.5	17	18.6
Shtërpçë	13	10.8	13	20.8	12	27.5	9	12.7	2	15
Graçanicë	33	17.9	13	15.9	38	17.1	12	17.3	21	23.7
Rahovec	27	13.9	2	23.5	20	29.8	14	15.9	14	14.9
Prizren	6	12.7	20	22.1	30	23.1	27	21.7	13	11.1
Prishtinë V	42	18.8	11	20.5	60	17.3	24	30.5	36	22.8
Lipjan	22	16.3	2	10.5	17	23.1	4	12.3	14	31.6
Novobërdë	2	26.5	0	0	4	35.3	3	18	8	31.3
Gjithsej	1.242	12.6	1.205	13.8	836	14.7	1.279	12.6	652	16.2